



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION**



„MASSMEDIA GROUP“ L.L.C.

Nr. i biznesit 71124908

Pronar – Gjergj ZIMAJ

OSHP “ TELE 1”

Rr/ Garibaldi Hyrja 17, Nr.7

Prishtinë

Ref: 1506/741/LIC/ni

Vendim

për licencimin e ofruesit të shërbimeve programore “TELE 1” – me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për distribuimin kabllor të programeve radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04), ka hyrë në fuqi më 6 korrik 2007, ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore të cilat programe do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më datën 20 mars 2015, kandidati për licencë të KPM-së “TELE 1”, ka parashtruar aplikacionin e kompletuar për licencë të KPM-së, në pajtim me Ligjin dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së.

Arsyetim

4. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjekte transmetuese.

5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “TELE 1”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullores CIMC 2007/04.
6. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “TELE 1” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth strukturës së qartë organizative, të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
7. Sipas nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, kandidati për licencë të KPM-së “TELE 1”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
8. Komisioni vlerëson se, kandidati “TELE 1” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve programore, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2013/04.

Vendim

9. Në takimin e mbajtur më datën 22 korrik 2015, Komisioni merr vendim që, kandidatit “TELE 1”, me seli në Prishtinë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore përmes rrjetit kabllor, në Republikën e Kosovës.

Lëshimi i Vendimit

10. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij. Kandidati mund të fillojë veprimtarinë e tij si operatorë kabllorë vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

05.08.2015
datë